



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

D R E J T O R I A P Ë R B U J Q Ë S I D H E P Y L L T A R I

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:			Kryetarin e Komunës z.Lutfi HAZIRI		
CC:					
NGA/OD/FROM:			Ramiz Ramadani – Drejtor i DBP		
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:			Rapoti tre mujor i punës, Janar-mars 2016		
Nr. i Zyrës: Br. Kancelarije: Room No:		Lokacioni: Lokacija: Extencion:		Data: Datum: Date:	04.04.2016

Puna e DBP është bazuar në planin vjetor të punës dhe objektivat e planifikuara për këtë tre mujor janë arritur plotësisht.

Në kuadër të shërbimeve këshillimore dhe shërbimit profesional, për periudhën tre mujore janë trajnuar 165 fermerë nga të gjithë sektorët.

Me datën 25.01.2016, kemi aplikuar në organizatën Qeveritare Turke TIKA, për mekanizim bujqësor. Kemi dorëzuar projektin detal me specifikacionin e duhur për 40 paisje bujqësore dhe implementimi i këtij projekti që kap shumën mbi **30,000.00 €**, është bërë dje, me datën 05.05.2016.



Me datën 02.02.2016, kemi publikuar listën e përfituesve për konstruksione të serrave, ku 10 fermerë kanë përfituar serra prej 300 m² dhe 10 fermerë të tjerë kanë përfituar serra prej 150 m². Ky projekt është finalizuar me datën 21.04.2016 dhe shuma e këtij investimi është **23,400.00 €**.



Gjatë muajit shkurt, farmerët janë njoftuar për skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR, dhe nga zyrtarë tona kanë marrur asistencë për konkurim në këto grante. Katër zyrtarë të DBP të trajnuar për digjitalizim të parcelave, kanë punuar në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim të fermerëve për subvencionet, proqes ky që do të vazhdojë deri më datën 10.05.2016.

Po ashtu kemi ndihmuar bujqit në plotësimin e aplikacioneve për mini – grante në organizatën Gjermane HELP. Janë asistuar 56 fermerë.

Publikimin e projektit të mjedresë e kemi bërë në fillim të muajit shkurt, dhe pas shqyrtimit të aplikacioneve të fermerëve kemi përzgjedhur 39 përfitues me sipërfaqe prej 10 ha. Implementimi i fazës së parë të këtij projekti ka filluar me datën 06.04.2016 dhe realizohet në partneritet me kompanin Fresh Fruit nga Lipjani. Faza e dytë do të realizohet në vjeshtë dhe vlera e këtij investimi është 60,000.00 €. Ne vlerësojmë se me këtë investim sigurohën minimum 100 deri 120 vende të reja të punës.



Nga data 25.02.2016, kemi bërë publikimin e thirrjes për farë të misrit ku kemi pranuar 414 aplikacione dhe pas verifikimit të listës kemi larguar 8 aplikues, ndërsa pjesa tjetër 406 fermerë kanë përfituar nga ky subvencion. Janë shpërndarë

600 thasë farë misri për mbjelljen e 320 ha. Projekti është implementuar me datën 13.04.2016 dhe ka koston **13,800.00 €**.



Nga këto projekte të realizuara për këtë periudhë kohore janë mbështetur mbi 500 fermerë. Janë investuar mbi **100,000.00 €** dhe vlerësojmë se janë siguruar rreth 150 vende të punës nga fermerët në pronat e tyre.

Përpos këtyre projekteve në proqes të implementimit janë edhe Projekti i centrifugave elektrike për nxjerrjen e mjaltit, Paisja e blegtorve me makina mjelëse lëvizëse dhe bidona të qumështit dhe Shtrimi i rrugëve të arave.

Kujdesshëm po punojmë edhe me partner dhe donator të ndryshëm si Care international, Haifer etj. dhe presim që edhe me këta partner të implementojmë projekte të cilët me kohë do ti bëjmë publik.

Spektori i Pyltarisë - Në këtë sektor veprojmë me kompetenca të kufizuara dhe fokusi ynë kryesor është ndalja e prerjeve ilegale të pyjeve.

Gjatë kësaj periudhe kemi ngritur 85 fletëparaqitje prej të cilave 68 për kundërvajtje, 10 penale dhe 7 për transport.

Për këtë periudhë tre mujore kemi pasur 5 raste të konfiskimit të druve në sasi prej 7.49 m³.

Në koordinim me Drejtorinë Rajonale të Pylltarisë, kemi planifikuar që të bëjmë rrallimin e 20 ha, dhjetë në majën e gjelbërt dhe dhjetë ha në pjesën e Karadakut. Gjithashtu, planifikojmë edhe gjelbrimin e 20 ha me pishë të sipërfaqeve të zhveshura në vjeshtë.

Spektori i Inspektionit për Bujqësi dhe Veterinari, gjatë kësaj periudhe tre mujore ka kryer këto vizita inspektuese:

Lloji i kontrollës	Numri
Kontrollime	132
Procesverbale	72
Therrje të kafshëve	326
Transport të kafshëve të gjalla	50
Denime	3
Përgjigje kërkesave të qytetarëve	2
Asistencë zyres regjionale të AUV	44